



Pranimi / Dorezuar Priljevoj / Predato Received / Delivery	13.04.2021	1	viti god year
Organ / Injesta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM&K	1753/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.218/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2180/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.391/2019 të datës 11.07.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga “Haraqina”, pa numër, lagja e Vreshtave në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.1934 të datës 11.06.2019 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.391/2019 e datës 11.07.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.1934 i datës 11.06.2019 i Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publike.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin për pozitën “Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë” të shpallur më datë 17.10.2017 nga Ministria e Administratës Publike. Pas përfundimit të fazës së intervistës Komisioni për Vlerësimin e Kriterëve i ka dërguar Ministrit të Administratës Publike emrat e tre (3) kandidatëve me më së shumti pikë në mesin e tyre edhe emrin e ankueses. Në bazë të provave të lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që Ministri i Ministrisë së Administratës Publike ka dërguar në qeveri emrat për emërim në këtë pozitë por nuk ka asnjë njoftim për anulim apo jo të procedurës.

Ministria e Administratës Publike, më datë 22.05.2019 ka shpall konkursin për pozitën “Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë”. Ankuesja kundër shpalljes së këtij konkursi më datë 03.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike.

Komisioni për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publike, më datë 11.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 1934 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.1934 të datës 11.06.2019 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.07.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 3094/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administratës Publike, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 3094/2019 të datës 11.07.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1934 të datës 11.06.2019 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike; Njoftimin për pozitën e Drejtorit të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë; Konkursin për pozitën “Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë” të shpallur nga Ministria e Administratës Publike më datë 22.05.2019; Ankesën e ankueses e datës 03.06.2019 e parashtruar nga ankuesja pranë Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.07.2019; Aktgjykimin A.nr.2180/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 28.08.2019 dhe E-mailin e datës 29.08.2019 nga ankuesja .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar,*

sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses dhe duke u bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën “Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë” respektivisht konkursi është shpallur me datë 17.10.2017, ndërsa procesi i vlerësimit të aplikacioneve dhe intervista më gojë ka përfunduar si rrjedhojë edhe Sekretaria e Komisionit për Vlerësimin e Kriteve pas përmbylljes së këtij procesi nëpërmjet njoftimit i ka dërguar Ministrit të Administratës Publike emrat e tre (3) kandidatëve me më së shumti pikë në mesin e tyre edhe emrin e ankueses, mirëpo përkundër faktit që Ministri i Ministrisë së Administratës Publike ka pranuar njoftimin me tre (3) kandidatët me më së shumti pikë, nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të dërguar të njëjtit në Qeverinë e Republikës së Kosovës për emërim dhe në këtë formë ka zgjedhur mënyrën e heshtjes administrative.

Handwritten notes and stamps in the bottom right corner, including a blue circular stamp with the text "Kolegji për shqyrtimin e ankesave" and some illegible handwritten text.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk kemi një vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për emërim të ndonjë kandidati në pozitën e lartcekur, dhe me vetë faktin që legjislacioni për shërbimin civil i Republikës së Kosovës për pozitën e nivelit të lartë drejtues nuk ka përcaktuar ndonjë afat për përfundim të procedurës, atëherë të aplikueshme janë dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht dispozitat e nenit 98 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktojnë se: ***“Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”***, në këtë rast kjo procedurë nuk ka përfunduar brenda këtij afati.

Meqenëse në këtë rast nuk kemi pasur veprime të mëtejshme dhe me vet faktin që ankuesja nuk është njoftuar për këtë, atëherë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se palët në procedurë në bazë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përveç që mund të parashtrojnë ankesë kundër një akti administrativ, ankesë mund të parashtrojnë edhe kundër mosveprimit të organit publik, në këtë rast edhe pse nuk janë ndërmarr veprime nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, ankuesja nga ajo kohë deri më datë 03.06.2019 nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të realizuar të drejtën e saj të pretenduar, rrjedhimisht sipas Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, meqenëse kemi pasur heshtje administrative në rastin konkret ankuesja për realizimin e të drejtës së saj të pretenduar është dashur që në kuptim të dispozitave të nenit 125 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të filloj procedimin administrativ nëpërmjet ankimit ashtu siç përcaktohet se: ***“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative)”***.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publike me rastin e refuzimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar se Komisioni për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publike me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.1934 të datës 11.06.2019, ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me legjislacionin në fuqi sepse ka shqyrtuar drejtë ankesën e ankueses duke vendosur në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, rrjedhimisht pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuar.

Duke marr parasysh nga shpallja e konkursit të datës 17.10.2017 për pozitën “Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë”, kanë kaluar me shumë se tri vite dhe duke pasur parasysh faktin e ndryshimit të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, meqenëse kjo procedurë nuk është përfunduar brenda afateve që përcaktuar me dispozitat e nenit 98 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konsiderohet që është procedurë e pavlefshme dhe nuk mund të obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës për të ndërmarr veprime për emërimin e kandidatit për pozitën Drejtor i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.2180/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër a.nr.218/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

Ankueses

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative;

Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Arkivit të KPMSHCK-së

